

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjet autobot për përballimin e përmbajtjeve në territorin e Bashkisë Maliq”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 34100000-8

VLERA E FONDIT LIMIT:

10,000,000 (*dhjetë milion*) lekë pa tvsh

12,000,000 (*dymbëdhjetë milion*) lekë me tvsh

Vlera e fondit limit është përlllogaritur bazuar në Ligjin nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Kreu VI “rregulla të përgjithshme dhe përgatitja e procesit të prokurimit”, neni 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, Vendimit nr.285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 12 “Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës”. Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit i ngritur me Urdher Titullari nr.483 prot date 31.07.2026 pasi ka bërë një studim të tregut ka gjetur oferta nga operatore ekonomike që operojnë në këtë fushë dhe ka llogaritur mesataren e cmimit të tregut duke nxjerrë dhe fondin limit për procedurën.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Maliq ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”., i ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):
Sipas kritereve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet **2023-2024-2025** të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 50 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, i ndryshuar, (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2 Kopje të deklaratave për xhiron vjetore të viteve **2023,2024,2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

(Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për "Procedurës Tatimore "neni 64 Deklarata Tatimore.

Kriteret e kërkuara në pikën **2.2.1** dhe **2.2.2**. janë vendosur me qëllim që të vërtëtohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë kapacitetet e nevojshme financiare për përmbushjen e kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, për vitin 2026 ,pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar dhe për vitin 2026(**këstet e maturuara të vitit 2026**) sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse,bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimet në nenin 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c,” Pasi cdo operator ekonomik duhet të ketë të paguara taksat dhe tarifat vendore prane njësive të qeverisjes vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, nga shpallja e njoftimit të kontratës ,ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% i fondit limit të kesaj kontrate

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin **publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe **fatura tatimore të shitjes** të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara** në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin **privat**, operatori ekonomik duhet të paraqesë **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **dhe të deklaruara** në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30% të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin permbledhes te vetdeklarimit se mjeti duhet te jete i pajisur me dokumentacionin e meposhtem:

- Lejë qarkullimi e vlefshme
- Certifikatë e kontrollit teknik e vlefshme
- Polica e sigurimit e vlefshme
- Taksa vjetore e mjeteve e vlefshme
- Fotografi te mjetit

“Në çdo rast, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti/entikontraktor i kërkon ofertuesit te kualifikuar I pari,që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit ,si më sipër.

Argumentim: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se mjeti te jete ne gjendje funksionale pune dhe i gatshem per tu perdorur nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë me shkrim me anë të së cilës marrin përsipër të kryejnë shërbimin e transportit të mallit objekt prokurimi brenda afatit dhe sipas specifikimeve teknike të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor në formularin e njoftimit të kontratës.

Argumentim: Në bazë të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se do të kryejnë shërbimin e transportit të mallit objekt prokurimi brenda afatit dhe sipas specifikimeve teknike të percaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë me shkrim me anë të së ciles deklaron se permbush specifikimet teknike te mjetit .

Argumentimi:Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ,i ndryshuar,dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.